

# **Kriteret për Licencim të Klubeve**

## **EDICIONI 2023/24**

### **Kriteret e Pjesëmarrjes**



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

**01 Qershor 2023**  
**Prishtinë**

# **Kriteret për licencimin e klubeve të basketbollit në Kosovë luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e cilësisë, integritetit, sigurisë dhe stabilitetit financiar të ligës.**

**Kriteret janë të dizajnuara për të siguruar që klubet e licencuara të basketbollit në Kosovë të jenë në gjendje të konkurrojnë në një nivel të caktuar, të ruajnë stabilitetin financiar dhe të operojnë në mënyrë të sigurt dhe etike.**

**Është e rëndësishme që klubet e basketbollit të plotësojnë kriteret për licencim për të garantuar cilësinë, integritetin dhe sigurinë e sportit. Megjithatë, klubet mund të përballen me sfida në përmbushjen e këtyre kërkesave, andaj është e rëndësishme që organet drejtuese të FBK të punojnë me klubet për të siguruar që ata të kenë mbështetjen dhe burimet që u nevojiten për të përmbushur kriteret.**



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## ÇKA ËSHTË LICENCIMI I KLUBEVE?


- PËRFORCON PROFESIONALIZMIN E KLUBEVE
  - PËRMIRËSON STANDARDET
- PËRFORCON KREDIBILITETIN E GARAVE TË KLUBEVE

PAKO KRITERESH QË DUHET TË PLOTËSOHEN QË KLUBET TË KENË TË DREJTË PËR TË MARRË PJESË NË GARA TË KLUBEVE

# KRITERI SPORTIV

**Klubet duhet të plotësojnë disa standarde të performancës sportive, duke përfshirë kërkesat minimale për ambientet, stafin stërvitor, zhvillimin e lojtarëve dhe programet për të rinjtë.**

**Cilat janë ato?**




# PËRMBAJTJA



**Kriteret e Pjesëmarrjes të klubeve të Superligës së Meshkujve, Superligës së Femrave, Ligës së Parë të Meshkujve dhe Ligës së Parë të Femrave:**

- **Kriteri Sportiv**
- **Kriteri Financiar**
- **Kriteri Ligjor**
- **Kriteri Administrativ dhe i Personelit**
- **Kriteri i Zhvillimit të të Rinjve**
- **Kriteri Etik dhe Disiplinor**
- **Kriteri Infrastruktural**



# KRITERI SPORTIV – Superliga e Meshkujve



## Kategoritë e Reja:

*Minimum 4 ekipe të kategorive të reja (U14, U16, U18 dhe Minibasketboll) duhet të lajmërohen për gara nga secili klub i Superligës së Meshkujve dhe për secilin ekip duhet të jetë përgjegjës në letër një trajner/e i licencuar.*

- Në rast se klubi nuk merr pjesë me asnjë kategori (U14, U16, U18 dhe Minibasketboll) në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24, klubi duhet të deponojë në FBK shumën prej 10,000.00 (dhjetë mijë) Euro, të cilat FBK do ti vendos tek buxheti i Qendrës Nationale të Basketbollit.
- Në rast se klubi merr pjesë me vetëm një kategori (prej U14, U16, U18 dhe Minibasketboll) në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24, klubi duhet të deponojë në FBK shumën prej 7,500.00 (shtatë mijë e pesëqind) Euro, të cilat FBK do ti vendos tek buxheti i Qendrës Nationale të Basketbollit.
- Në rast se klubi merr pjesë me vetëm dy kategori të reja (prej U14, U16, U18 dhe Minibasketboll) në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24, klubi duhet të deponojë në FBK shumën prej 5,000.00 (pesë mijë) Euro, të cilat FBK do ti vendos tek buxheti i Qendrës Nationale të Basketbollit.
- Në rast se klubi merr pjesë me vetëm tri kategori (prej tyre: U14, U16, U18 ose Minibasketboll) në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24, klubi duhet të deponojë në FBK shumën prej 2,500.00 (dy mijë e pesëqind) Euro, të cilat FBK do ti vendos tek buxheti i Qendrës Nationale të Basketbollit.

# KRITERI SPORTIV – Liga e Parë e Meshkujve



## **Kategoritë e Reja:**

*Minimum dy ekipe të kategorive të reja (prej U14, U16, U18 dhe Minibasketboll) duhet të lajmërohen për gara nga secili klub i L1 dhe për secilin ekip duhet të jetë përgjegjës në letër një trajner/e i licencuar.*

- **Në rast se klubi nuk merr pjesë me asnjë kategori (U14, U16, U18 dhe Minibasketboll) në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24, klubi duhet të deponojë në FBK shumën prej 5,000.00 (dhjetë mijë) Euro, të cilat FBK do ti vendos tek buxheti i Qendrës Nacionale të Basketbollit.**
- **Në rast se klubi merr pjesë me vetëm një kategori (prej U14, U16, U18 dhe Minibasketboll) në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24, klubi duhet të deponojë në FBK shumën prej 2,500.00 (pesë mijë) Euro, të cilat FBK do ti vendos tek buxheti i Qendrës Nacionale të Basketbollit.**

*Të gjithë trajnerët që dëshirojnë të punojnë me kategoritë e reja e kanë të obligueshëm shkollimin për trajnerë që organizohet në bashkëpunim me Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA) dhe përfundimin me sukses të atij shkollimi.*

# KRITERI SPORTIV – Superliga e Femrave



## Kategoritë e Reja:

***Minimum dy ekipe të kategorive të reja U16 dhe U18 duhet të lajmërohen për gara nga secili klub i Superligës së Femrave dhe për secilin ekip duhet të jetë përgjegjës në letër një trajner/e i licencuar.***

- Në rast se klubi nuk merr pjesë me asnjë prej kategorive të lartpërmendura në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24 duhet të deponojë në FBK shumën prej 5,000.00 (pesë mijë) Euro, të cilat FBK do ti shfrytëzoj për zhvillim të basketbollit femëror në vendin tonë.
- Në rast se klubi merr pjesë me vetëm një prej dy kategorive të lartpërmendura në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24 duhet të deponojë në FBK shumën prej 2,500.00 (dy mijë e pesëqind) Euro, të cilat FBK do ti shfrytëzoj për zhvillim të basketbollit femëror në vendin tonë.

***Të gjithë trajnerët që dëshirojnë të punojnë me kategoritë e reja e kanë të obligueshëm shkollimin për trajnerë që organizohet në bashkëpunim me Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA) dhe përfundimin me sukses të atij shkollimi.***



# KRITERI SPORTIV – Liga e Parë e Femrave



## **Kategoritë e Reja:**

*Minimum një ekip të kategorive të reja U14 duhet të lajmërohet për gara nga secili klub i Ligës së Parë të Femrave dhe për secilin ekip duhet të jetë përgjegjës në letër një trajner/e i licencuar.*

- **Në rast se klubi nuk merr pjesë me asnjë kategori në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24 duhet të deponojë në FBK shumën prej 1,500.00 (pesë mijë) Euro, të cilat FBK do ti shfrytëzoj për zhvillim të basketbollit femëror në vendin tonë.**

*Të gjithë trajnerët që dëshirojnë të punojnë me kategoritë e reja e kanë të obligueshëm shkollimin për trajnerë që organizohet në bashkëpunim me Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA) dhe përfundimin me sukses të atij shkollimi.*

# KRITERI FINANCIAR



**Klubet duhet të demonstrojnë stabilitet financiar, duke përfshirë dhënien e raporteve financiare, duke demonstruar se kanë paguar çdo borxh të papaguar dhe duke treguar se kanë burime të mjaftueshme financiare për të operuar gjatë edicionit.**

- **Financa të audituara (mundësi për aplikim për sponsorizim sipas ligjit), xhirollogari bankare (zyrtare).**

## ***Obligimet në FBK dhe FIBA:***

- ***Shlyerja e borxheve ndaj FIBA-s është kusht i domosdoshëm për licencim, konform Propozicioneve dhe Rregullores së Garave të FBK-së.***
- ***Obligimet aktuale në FBK duhet të paguhen si përmbushje e kriterëve, 50%, kurse pjesa tjetër e borxhit duhet të programohet dhe të paguhet konform marrëveshjes së përgatitur nga FBK dhe nënshkruar nga të dyja palët.***

# KRITERI LIGJOR



**Klubet duhet të sigurojnë dëshmi se janë të regjistruar si person juridik, kanë paguar të gjitha taksat dhe tarifatat e nevojshme dhe të jenë në përputhje me të gjitha rregulloret ligjore përkatëse.**

- **I licencuar pranë Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Kosovës**
- **Aktet normative të klubit të miratuara në Kuvend**
- **Organizimi i Kuvendeve të rregullta vjetore**
- **Organizimi i Kuvendeve Zgjedhore dhe zgjedhja e organeve të klubit**
- **Respektimi i akteve normative të FBK-së**
- **Dëshmi për kryerje të obligimeve ndaj Administratës Tatimore të Kosovës/Marrëveshja me ATK-në**

# KRITERI INFRASTRUKTUROR



**Klubet duhet të dëshmojnë se objektet e tyre plotësojnë disa standarde për sigurinë, higjienën dhe aksesin.**

- **Sigurimi i kushteve për stërvitje dhe ndeshje të të gjitha gjeneratave**
- **Sigurimi i kushteve për ndeshje dhe organizim të ngjarjeve/eventeve konform Propozicioneve/Rregullores së Garave dhe konform Rregullave Zyrtare të FIBA-s**

# KRITERI I ZHVILLIMIT TË TË RINJVE



**Klubet duhet të kenë një program për të rinjtë dhe të dëshmojnë se po zhvillojnë në mënyrë aktive lojtarë të rinj.**

- **Organizimi i të gjitha gjeneratave të kategorive të reja prej Minibasketbollit e deri tek U18**
- **Krijimi i Akademive të klubeve (emërimi i një Koordinatori)**
- **Investimi në kuadrot vendore (trajnerët/et)**

# KRITERI ADMINISTRATIV DHE I PERSONELIT



**Klubet e basketbollit duhet të ketë personel të kualifikuar, duke përfshirë këtu trajnerët dhe stafin administrativ. Ky personel duhet të ketë kualifikimet dhe përvojën e nevojshme për të menaxhuar ekipin në mënyrë efektive.**

- Zyre me hapësirë për takime, internet, email, website, FB zyrtare, strukturë të rregullt dhe me mandat në fuqi të lajmëruar në MAP, strukturë të rregullt dhe me mandat në fuqi të lajmëruar në Komunë/FBK.**
- 1 person i punësuar në administratë (Sekretar Teknik) dhe 1 person i punësuar si Zyrtar Financiar.**

# KRITERI ETIK DHE DISIPLINOR



**Klubet duhet të respektojnë të gjitha rregulloret përkatëse etike dhe disiplinore, duke përfshirë lojën e ndershme, politikat kundër dopingut dhe kundër racizmit. Kjo përfshin shmangien e çdo sjelljeje të paligjshme ose joetike, promovimin e lojës së ndershme dhe sjelljen e mirë sportive dhe ruajtjen e vlerave të sportit.**

- **Respektimi i Kodit Etik të FBK-së**
- **Respektimi i Rregullores Disiplinore të FBK-së**
- **Respektimi i Rregullores së Anti-Dopingut të FBK-së (së bashku me listën e WADA-s 2023)**

# LICENCIMI I KLUBEVE: PËRFITIMET PËR HISEDARËT



## TRAJNERËT

- Të sigurojnë kualifikimin/licencimin
- Trajnim i vazhdueshëm

## PRINDËRIT

- Përmirësimi i trajnimit dhe strukturës
- Politika të sigurisë
- Komunikim më i mirë me prindërit

## LOJTARËT

- Përmirësimi i trajnimit
- Mundësi për vullnetarizëm

## ADMINISTRATOR

- Trajnim në qeverisje/administrim
- Gjenerim i të hyrave
  - Përmirësim të mbarëvajtjes në ditën garës

## QEVERIA LOKALE

- Zhvillim të objekteve
- Zhvillim të komunitetit



**JU FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN!**



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA